

Të nxënësit vetërregullues dhe dimensionet e tij, një faktor i rëndësishëm i arritjes shkollore



Gjuhësi

Fjalët kyçe: të nxënësit vetërregullues, rregullimi konjitiv, metakonjicioni, rregullimi motivues, arritjet shkollore.

Johana Myftiu

Universiteti i Elbasanit, Elbasan, Shqipëri.

Ekstrakt

Mësimdhënia me në qendër nxënësin, kërkon prej tij aftësi për të kontrolluar dhe vetërregulluar procesin e të nxënës. Në këtë punim synohet të jepen marrëdhëniet midis këtyre aftësive dhe arritjeve mësimore të nxënësve. Vlerësohen dhe analizohen këto aftësi duke u ndalur në dimensionet më të rëndësishme, si në motivacionin, vendosjen e qëllimeve, metakonjicionin dhe strategjitë e të nxënës, si dhe në kontrollin e sjelljeve të përfshira në të nxënës. Procesi vetërregullues shihet si një proces ciklik, i ndarë në faza që ndikojnë njera-tjetrën dhe që përfshijnë në vetvete aktivitetet apo sjellje me natyrë konjitive, motivuese, afektive. Analiza e këtyre dimensioneve në mjediset shkollore si dhe rezultatet e gjetura, tregojnë që ka një korrelacion midis tyre dhe arritjes, pasi nxënësit që i zotërojnë dhe i përdorin këta komponentë, tregojnë arritje më të mira krahasuar me ata që nuk i përdorin. Një tjetër përfundim i rëndësishëm është se mësuesit duhet të modifikojnë sjelljet në mjediset e të nxënës, të bëhen të vetëdijshëm për rëndësinë e tyre dhe të dinë se këto aftësi mund të zhvillohen dhe t'u mësohen nxënësve. Sot studiuesit diskutojnë mbi qasjet më efektive të instruksionit, që lehtësojnë përvetësimin e strategjive vetërregulluese nga nxënësit.

Hyrje

Të nxënësit, parë në këndvështrimin psikologjik, neurologjik e socio-kulturor, është një proces mjaft i ndërlikuar. Korrelacionet e faktorëve ndikues janë të panumërt, shumë dimensionale dhe shpesh të padukshëm. Në këtë punim do të ndalemi në evidentimin e rolit të disa komponentëve psikologjikë shumë të rëndësishëm të lidhur me vetërregullimin, që pak njihen dhe praktikohen nga nxënësit. Por edhe mësuesit shpesh nuk i vlerësojnë si duhet dhe nuk e nxisin edukimin e aftësive vetërregulluese.

Një nxënës që di të vendosë qëllime, që di të planifikojë, të përzgjedhë strategji, të vetëkontrollojë tërë këto procese, ka shumë gjasa të arrijë suksesin krahasuar me nxënësin që nuk i përdor këto procese. Lypset që, edhe mësuesit edhe nxënësit të familjarizohen me këto koncepte që lidhen me vetërregullimin dhe me strategjitë e teknikat që duhet të përdorin për të identifikuar dhe nxitur të nxënësit vetërregullues në klasë.

Mësuesit nuk duhet ta shohin të nxënësit si një proces të përgjithshëm, apo t'i lidhin sukseset e dështimet e nxënësve vetëm me etiketimet të përgjithshme, si mungesë vullneti, mungesë vemendjeje, etj. Ata duhet ta ndihmojnë nxënësin t'i fitojë këto aftësi me ndihmën e teknikave të ndryshme të instruksionit. Rregullimi dhe kontrolli i të nxënës i ndihmon ata si t'i qasen situatave dhe çështjeve mësimore duke zbatuar strategjitë e ndryshme, duke monitoruar performancën e tyre dhe reflektuar rezultatet e përpjekjeve të tyre.

Konceptimet teorike të vetërregullimit

Vetërregullimi është një aspekt qendror i zhvillimit njerëzor. Nëse fëmijët nuk mësojnë të kontrollojnë sjelljen e tyre – të shmangin gjërat që mund të shmangen, të alternojnë strategjitë që nuk janë duke funksionuar etj, - ata do të jenë vazhdimisht dhe në çdo moment, nën “mëshirën” e shtytjeve dhe tërheqjeve të rrethanave të tyre.¹⁹⁶

Termi vetërregullim është bërë i njohur nga studimet e shumë psikologëve, sidomos në 2-3 dhjetëvjeçarët e fundit. Zimmerman ishte i pari që futi në psikologjinë e edukimit konceptin e të nxënës vetërregullues duke sjellë një sërë studimesh të rëndësishme dhe me vlerë për praktikën shkollore. Vetërregullimi është një proces i të nxënës që integron një tërësi sjelljesh konjitive, metakonjitive, motivuese, emocionale dhe sjellore. Nxënësit vetërregullues, sipas tij, karakterizohen nga aftësia e tyre për të qenë “pjesëmarrës aktivë nga ana metakonjitive, motivuese dhe sjellore në procesin e tyre të të nxënës” (Zimmerman, 1986). Vetërregullimi nuk duhet parë si një aftësi mendore apo një aftësi performance, por më tepër si një proces i vetëdrejtuar, nëpërmjet të cilit aftësitë transformohen brenda aftësive të lidhura me detyrën në fusha të ndryshme. Vetërregullimi:

“...përfshin vetëveprimin për të ndryshuar reagimet personale” (Schmeichel dhe Baumeister, 2004, fq.86)

“një tërësi e lidhur funksionesh ekzekutive dhe vepruese (p.sh. planifikim, orientim i ardhshëm, sjellje e drejtuar nga qëllimi, kontroll i përpjekjeve, sjellje proaktive)” (Mischel dhe Ayduk, 2004, fq. 99).

Sipas Vigotskit (1979), ndërkohë që fëmijët fitojnë njohuri të reja, njëherazi fitojnë dhe mënyrat për të rregulluar dhe kontrolluar përdorimin e këtyre njohurive prej tyre. Ndër të tjera, ai e përshkruan vetërregullimin si një funksion të gjuhës së brendëshme.

Në paradigmat e reja edukative me në qendër nxënësin, synohet të rritet niveli i përgjegjësisë së nxënësit për të kontrolluar dhe vetërregulluar proceset e të nxënës të tyre individual (Chen, 2002). Të nxënësit vetërregullues është një teori edukimi e ndikuar nga teoria konstruktivistike (Ben-Ari, 1998) dhe të nxënës social (Bandura, 2001).

¹⁹⁶ Vasta, Ross., Haith M.Marshall., Miller, A. Scott (1992). Child Psychology, fq.492

Përse është i rëndësishëm vetërregullimi? Shkurt, mund të themi se ai siguron:

- Arritje më të larta akademike
- Angazhim më të madh shkollor
- Pranim social të të barabartëve

Ka një vetëdije të rritur të psikologëve të zhvillimit të lidhur me faktin që, sa më mirë një fëmijë të vetërregullojë sjelljet e tij, aq më mirë do të ndeshet me sfidën e zotërimit të aftësive dhe koncepteve gjithnjë e më komplekse.¹⁹⁷

Termi vetërregullim ka *natyrë integruese*. Kjo i ka nxitur kërkuesit të studiojnë në mënyrë më të gjërë dhe të lidhura me kontekstin, mjaft çështje të të mësuarit dhe të nxënësve, duke treguar vlerat reale të të nxënësve vetërregullues dhe duke e parë atë si një objekt edukativ në të gjitha nivelet e shkollimit.

Të nxënësve vetërregullues dhe arritja akademike

Kërkimet kanë treguar që, nxënësit me arritje të larta në shkolla apo kolegje, *shfrytëzojnë më shumë strategji vetërregulluese se sa nxënësit me rezultate të ulta*. Zimmerman dhe Martinez-Pons (1986) zhvilluan intervista për të krahasuar vetëraportimet e nxënësve me arritje të larta dhe të ulëta, për strategjitë e përdorura në një sërë problemesh të dhëna. Sipas tyre, nxënësit me arritje më të larta jo vetëm përdorin më shumë strategji se ata me arritje më të ulëta, por i përdorin ato më shpesh.

Janë gjetur asociacione midis suksesit të të rinjve për të kontrolluar sjelljet e tyre konjitive, motivuese, emocionale dhe suksesit shkollor. Zotërimi i aftësive vetërregulluese *ndikon mjaft edhe në aspektin social*. Fëmijët dhe adoleshentët që tregojnë nivel të ulët të aftësive vetërregulluese janë në rrisht më të madh për mospranimin e të barabartëve, për të pasur probleme sociale si kriminalitet etj.

Të nxënësve vetërregullues dhe sasia e njohurive

Ka tregues që, me rritjen e moshës, rriten aftësitë e përdorimit të strategjive vetërregulluese. Kjo mund të reflektojë ndryshimet e pjekurisë së trurit, por mund të jetë dhe rezultat i rritjes së sasisë së njohurive që merr nxënësi. Në një kërkim të Glaser (1984) tregohet që *sasia e njohurive tek individët ekspertë në një fushë të caktuar, ndikon qasjen e tyre ndaj të nxënësve*. Gjetjet sugjerojnë që ndërsa rriten njohuritë bazë, fëmijët bëhen më të aftë të përdorin strategji të sofistikuara të klasifikimit dhe kujtesës. Një çështje me interes në studime, ka qënë ai i lidhur me faktin se *në cilin moment*, nxënësi i përdor në mënyrë eficiente dhe të automatizuar strategjitë e ndryshme vetërregulluese, në stadet e hershme të të nxënësve të një informacioni a detyre të re mësimore, apo më pas. Gjetjet kanë treguar që, në këto fillime, aftësitë e procesimit të individit drejtohen tek procedurat bazë dhe ka pak aftësi e kapacitete të lidhura me proceset vetërregulluese të detyrave specifike (Winne, 1995)

Vetërregullimi, të paktën pjesërisht, është një proces konjitiv që ndihmon kapacitetin mendor, çka do të thotë që *burimet mendore janë pjesë e proceseve vetërregulluese dhe proceseve konjitive që përfshihen në realizimin e një detyre*.¹⁹⁸ Nxënësit me njohuri të pakta dhe ata të cilëve u mungojnë njohuritë e duhura se kur mund të përdorin njohuritë specifike në mënyrë efektive, nuk mund të jenë të aftë të gjejnë burimet mendore për të menduar njëkohësisht rreth vetërregullimit. Është shumë më e lehtë për një nxënësi të praktikojë strategji të reja mbi një sërë problemesh me të cilat është i familjarizuar dhe i njohur mirë. Kjo është në përputhje me gjetjet që, fëmijët zbulojnë strategji të reja kur janë të suksesshëm në kompletimin e problemeve (Sieglar, 2000).

Motivacioni, vendosja e qëllimeve dhe të nxënësve vetërregullues

Kërkuesit mbi motivacionin sugjerojnë që eksperiencat subjektive të nxënësve dhe besimet e tyre rreth të nxënësve, luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe zhvillimin e vetërregullimit (Pintrich, 2000). Sipas teorisë së pritshmëri-vlerave, motivacioni për të nxënë është një funksion i pritshmëri të individit, të lidhura me rezultatet e mundshme të një aktiviteti të të nxënësve dhe shkallën me të cilën personi e vlerëson të nxënësit ose arritjen (Eccles etj., 1998).

Nxënësit që kanë *pritshmëri pozitive* rreth aftësisë së tyre për të kontrolluar të nxënësit dhe për arritje, kanë më shumë gjasa të shfrytëzojnë strategji vetërregulluese dhe të dalin mirë në shkollë. Por akoma ka tregues të pamjaftueshëm për të konfirmuar drejtimet shkakësore të këtyre ndikimeve.¹⁹⁹

Nxënësit i vlerësojnë detyrat edhe nisur nga fakti nëse janë të motivuar së jashtmi apo së brendshmi. Nxënësit që vlerësojnë detyrat për *arsye të brendshme* tentojnë të shfrytëzojnë më shumë strategji vetërregulluese (Pintrich 1989; Pintrich dhe Garcia 1991).

Edhe *orientimi i nxënësve drejt qëllimeve të të nxënësve* si dhe mënyra si e konceptojnë ata të nxënësit, janë faktorë të lidhur me motivacionin dhe vetërregullimin. Kërkuesit e motivacionit kanë identifikuar dy orientime kryesore të nxënësve: *“një orientim performancë”* nëpërmjet të cilit nxënësit janë të interesuar kryesisht të tregojnë që kanë aftësi më të mëdha se të tjerët, dhe një *“orientim zotërimi të të nxënësve”* ku nxënësit janë më të lidhur me të kuptuarit e përmbajtjes (Dweck 1999;2001; Nicholls 1992).

¹⁹⁷ www.self-regulation.cea-ace.ca/education-canada/article

¹⁹⁸ Ireson, Judith. (2008). Learners, Learning and Educational Activity, fq.56

¹⁹⁹ Ireson, Judith. (2008). Learners, Learning and Educational Activity, fq.61

Të parët ka më shumë gjasa të përdorin riprodhimin dhe strategji të thjeshta të procesimit të informacionit. Nxënësit që janë të orientuar nga qëllimet e zotërimit, janë të interesuar të përmirësojnë të nxënët e tyre personal dhe i arrijnë qëllimet e tyre duke përdorur aftësitë vetërregulluese.

Format e vetërregullimit

Sipas studiuesve, format e ndryshme të vetërregullimit janë të ndryshme në faza të ndryshme të kryerjes së detyrave. Ka diferenca cilësore midis tipeve të rregullimit të nevojshme për tu përdorur *përpara, gjatë dhe pas* një detyre të të nxënët (Pintrich 2000; Puustinen dhe Pulikinen 2001), të cilat pasqyrohen në tabelën më poshtë:

Fazat e vetërregullimit	Fushat e vetërregullimit			
	Njohja	Motivacioni	Sjellja	Konteksti
Faza paraprake, planifikimi	Vendosja e qëllimeve, aktivizimi i përmbajtjeve të mëparshme, njohja metakonjitive	Vetëefikasiteti, orientimet e qëllimeve	Koha dhe përpjekjet e planifikimit	Vetëdija për detyrën dhe kontekstet, që mund të ndihmojnë ose pengojnë të nxënët.
Monitorimi	Vetëdija metakonjitive dhe monitorimi i njohjes	Vetëdija për vetëefikasitetin, vlerat, atribuimet, interesat, ankthet.	Koha dhe drejtimi i përpjekjeve	Monitorimi i kontekstit
Kontrolli	Selektimi dhe përshtatja e strategjive konjitive dhe metakonjitive.	Ruajtja e motivacionit	Zgjerimi i përpjekjeve	Ndikimi i kontekstit
Refleksioni	Gjykimet konjitive, atribuimet	Vlerësimi i motivacionit	Vlerësimi i sjelljes	Reflektimi mbi kontekstin

Tabela 1: Burimi: I shkurtuar nga Pintrich 2000, me lejen e Elsevier

Sipas Barry Zimmerman (1989) të nxënët vetërregullues ka të bëjë me rregullimin e 3 aspekteve të përgjithshme të të nxënët: *vetërregullimi i sjelljes* (kontrolli i kohës, mjedisit të studimit, komunikimi me të tjerët dhe të barabartët etj.); *vetërregullimi i motivacionit dhe ndjenjave* (kontrolli dhe ndryshimi i besimeve motivuese si vetëefikasiteti, orientimi i qëllimit, kontrolli i emocioneve etj.); *vetërregullimi i njohjes* (kontrolli i strategjive të ndryshme konjitive të të nxënët siç janë strategjitë e procesimit të informacionit etj.).

Si të ndërhyjmë për të edukuar vetërregullimin?

Përpjekjet për t'i mësuar nxënësve direkt strategjitë konjitive në kushtet e laboratorit qenë pak të suksesëshme. Gjatë 1980, kërkimet mbi strategjitë u zhvendosën brenda klasës, por dhe në këto mjedise të mësuarit direkt të strategjive vetërregulluese ishte relativisht jo efektive. Rezultatet e një studimi mbështetur në të mësuarit reciprok, ishin më efektive. Këto dhe të tjera programe, inkurajojnë reflektimin mbi të menduarit, se sa përdorimin e një qasjeje direkt për tu mësuar nxënësve përdorimin e strategjive metakonjitive.

Shumica e programeve të përmendura më lart, janë projektuar për adoleshentët ose të rriturit. Megjithatë, është vënë re që, madje dhe fëmijët e vegjël mund të inkurajohen për të reflektuar mbi të nxënët e tyre (Adey etj. 2002). Ai mund t'i mësohet fëmijëve dhe të rriturve. Por duhet të jemi të vemendshëm: *nuk duhet t'i mësojmë secilit të njëjtat strategji*. Vetërregullimi është një proces fleksibël dhe përshtatës: për nxënës të ndryshëm mund të theksohen lloje të ndryshme strategjish dhe sjelljesh motivuese. Ai nuk mund të reduktohet thjesht në një listë hapash për tu ndjekur, pasi është i lidhur me veprime dinamike të nxënësve që përfshihen në një proces kompleks siç është të nxënët.

Mësuesit e mençur ua përshtasin metodat e tyre të instruksionit të nxënët të nxënësve dhe përpiqen të përfshijnë sa më shumë komponentë vetërregullues në atë çka u mësojnë dhe në atë çka shpresojnë nga nxënësit e tyre.

Metodologjia

Për të marrë një informacion mbi këto dimensione të rëndësishme të të nxënët, realizova një sondazh të thjeshtë me subjekte nga shkolla e mesme "Luigj Gurakuqi" i qytetit të Elbasanit, në vitin e 2 dhe të 3. Numri i subjekteve është 96 nxënës, nga këto 61 femra dhe 35 meshkuj.

Hipoteza e ngritur është: përdorimi i strategjive vetërregulluese, ndikon pozitivisht në arritjen shkollore. Njëherazi, kjo arritje është e lidhur me qëllimet e të nxënët, besimet motivuese etj. Arritjet shkollore janë matur nisur nga vetëraportimet e nxënësve që plotësuan pyetësonin, për notën mesatare të tyre.

Instrumenti i përdorur është pyetësi me pyetje të hapura dhe të mbyllura, si dhe vetëraportimi. Ndërtova dhe administrova 3 pyetësorë, mbështetur në gjetjet teorike të cituara më sipër mbi këtë argument. Kryesisht synova të marr të dhëna nëse nxënësit i posedojnë dhe i përdorin këto elementë të vetërregullimit përpara fillimit të një detyre, gjatë dhe pas përfundimit të detyrës. Njëherazi, kisha si synim të mas vetëm disa nga dimensionet e vetërregullimit në faza të ndryshme të tij, si: planifikimin dhe vendosjen e qëllimeve të të nxënës, atribuimin të lidhur me motivacionin si dhe nivelin e menaxhimit dhe kontrollit dhe reflektimin.

Përgjigjet nga pyetësi i 1 janë mbledhur me anë të shkallës 5-pikëshe të Likert.

Për përpunimin e të dhënave janë përdorur elementë të thjeshtë të statistikës deskriptive.

Paraqitja e të dhënave është bërë me ndihmën e diagramit rrethor.

Në pyetësin 1, grupi i pyetjeve **1, 2, 5, 7, 9** ka të bëjë me rëndësinë e aftësive vetërregulluese përpara realizimit të një detyre. Nga 96 nxënës, rreth 42 nxënës apo 43,7% e tyre janë dakord dhe 17 nxënës ose 17,6% e tyre shumë dakord me planifikimin, vendosjen e qëllimeve etj.; ndërsa 5 nxënës ose 5,4% nuk janë aspak dakord, 13 nxënës ose 13,4% - jo dakord dhe 19 nxënës ose 19,9% asnjëherë.




Tabela 2: Të dhëna për sjelljet vetërregulluese përpara realizimit të një detyre

Grupi i pyetjeve 3, 6, 12, 13, 14 synon të masë ekzistencën e sjelljeve vetërregulluese që përdoren gjatë realizimit të një detyre. Nga analiza e të dhënave del se: 6 nxënës ose 6,3 % janë aspak dakord, 9 nxënës ose 9,4% janë jo dakord, 2 nxënës ose 2% asnjëherë; 42 nxënës ose 43,8 % janë shumë dakord, 37 nxënës ose 38,5 % janë dakord me këto sjellje vetërregulluese që përdoren gjatë realizimit të një detyre.




Tabela 3: Të dhëna për sjelljet vetërregulluese që përdoren gjatë realizimit të një detyre

Grupi i pyetjeve që synon të marrë të dhëna për sjelljet vetërregulluese pas realizimit të një detyre është **4, 11, 15**. Nga analiza e të dhënave: 6 nxënës ose 6,2% nuk janë aspak dakord, 10 nxënës ose 9,6% jo dakord dhe 17 nxënës ose 17,6% janë asnjëherë në përgjigjet e tyre. Ndërsa, 34 nxënës ose 35,3% janë dakord dhe 29 nxënës ose 31,3% janë shumë dakord.




Tabela 4: Të dhëna për sjelljet vetërregulluese pas realizimit të një detyre

Nga administrimi i **pyetësorit 2**, me pyetje të mbyllura, janë 4 pyetje me nga 4 alternativa. Pyetja 1 synon të shohë aftësitë vetërregulluese të lidhura me qëllimet që vendosin nxënësit për të nxënë, qëllime performance apo zotërimi. Pyetja 2 dhe 4 i shoh të lidhura këto aftësi me atribuimet e shkaksisë (të brendshme apo të jashtme) dhe pyetja 3, të lidhura me reflektimin.

Për pyetjen 1: për variantin **a** (për të kënaqur të tjerët), janë përgjigjur 8 nxënës ose 8,4%; variantin **b** (për tu dalluar) 0%, variantin **c** (për notë max) 38 nxënës ose 39,6%, dhe variantin **d**, (për përvetësim njohurish), 50 nxënës ose 52%.




Tabela 5: Aftësitë vetërregulluese të lidhura me qëllimet që vendosin nxënësit për të nxënë, qëllime performance apo zotërimi

Për pyetjen 2 dhe 4: variantin **a** (puna e tyre dhe besimi) e kanë zgjedhur 66 nxënës ose 68,8% e tyre; 24 nxënës ose 25,4% e tyre ia atribuojnë suksesin fatit, testit të lehtë, ndihmës së të tjerëve (varianti b dhe c) dhe 6 nxënës ose 5,8% nuk kanë besim në forcat e veta (varianti d).




Tabela 6: Aftësitë vetërregulluese të lidhura me atribuimet e shkakësisë

Për pyetjen 3: variantin **a** e kanë zgjedhur 8 nxënës ose 8,4%, dhe pjesa tjetër 91,6% kanë zgjedhur variantin **b**, **c** dhe **d**.




Tabela 7: Aftësitë vetërregulluese të lidhura me reflektimin

Pyetësori 3, me pyetje të hapura, synonte të mblidhte informacion nga komentet e nxënësve për problematikat e trajtuara më lart nisur nga përjetimet personale gjatë të nxënë të lidhura me: planifikimin dhe menaxhimin e kohës, të vemendjes, përshkrimin e një plani paraprak për një detyrë mësimore, aftësitë metakognitive etj.

Për menaxhimin dhe planifikimin e kohës, për pyetjen (1) “**E përcaktoni kohën që ju duhet për çdo detyrë, apo vazhdoni derisa të mbaroni**”, vetëm 12% e nxënësve shprehën se e planifikojnë kohën, të tjerët, rreth 88% shprehën se vazhdojnë derisa të përfundojnë detyrat.

Për pyetjen (3): “**Përshkruani shkurt për çfarë mendoni konkretisht kur përpiloni një plan paraprak për një detyrë mësimore**”, shumë pak prej tyre, rreth 6% shprehën qartë për hapa kryesore, pjesa tjetër flasin në përgjithësi, duke treguar mangësi në këtë drejtim.

Për pyetjen (5): “**Çfarë ndodh me ju kur gjatë leximit për të përvetësuar një material mësimor nuk arrini ta kuptoni atë: vazhdoni më tej?, e ndërprisni? Jepni mendimin dhe alternativat tuaja**”, rreth 28% shprehën se vazhdojnë të lexojnë; 36% shprehën se e ndërpresin dhe fillojnë ta rilexojnë, pa përmendur asnjë teknikë tjetër; 16% shprehën se përpiqen të gjejnë arsyet, të nxjerrin lidhjen e informacionit me ato të marra më parë, të kërkojnë ndihmë etj, 18% shprehën vetëm se do të kërkojnë ndihmë nga mësuesja apo familjarët dhe 2% nuk përgjigjen fare.

Për pyetjen (6): “**Tregoni disa hapa apo teknika personale që përdorni ju gjatë zgjidhjes së një detyre në një lëndë të caktuar**”, vetëm 7% e nxënësve, në mënyra të ndryshme, kishin renditur hapa të tillë si grumbullimi i informacioneve, përpunimi në mendjen time, nxjerrja e idesë kryesore, përmbledhja e informacionit, krahasimin me informacione të tjera, sjell shembuj, etj. Përgjigjet e pjesës tjetër linin shumë për të dëshiruar, duke nisur nga përgjigje të tipit standart lexoj mësimin, pastaj bëj detyrat e deri tek përgjigja “nuk kam hapa të veçantë”!

Analizë dhe diskutim

Duke i analizuar dhe duke i parë përgjigjet e 3 pyetësorëve në ndëryprim dhe se si ndikojnë tek njëri tjetri, konkludojmë që: edhe pse një pjesë e mirë e nxënësve në pyetësorin e parë e vlerësojnë planifikimin dhe vendosjen e qëllimeve; dy pyetjeve në pyetësorin 3 që lidhen me kërkesën për të treguar konkretisht si planifikojnë apo vendosin qëllime, çuditërisht, vetëm një përqindje e vogël e tyre i përgjigjen se mund t'i realizojnë këto sjellje gjatë të nxënësve. Po kështu, nga përpunimi i të dhënave të përgjigjeve për pyetjet 13,14,15, të pyetësorit 1, të cilat kryesisht lidhen me ekzistencën e aftësive metakognitive, del se një përqindje dërmuese e nxënësve janë vlerësues për rëndësinë e këtyre aftësive, po kështu edhe në pyetjen 3 të pyetësorit 2 që lidhet me kontrollin e reflektimin e sjelljeve konjitive gjatë të nxënësve, nga shumica e nxënësve zgjidhen përgjigjet që i vlerësojnë ato, por nuk ndodh kështu, kur në pyetësorin 3, po për këto dimensione, sidomos në pyetjen 4 dhe 6, tregojnë mangësi në përdorimin praktik të këtyre aftësive.

Pra, ka një *mospërputhje midis asaj çka nxënësit e njohin si të rëndësishme të lidhur me aftësitë vetërregulluese dhe mundësisë për t'i zotëruar këto aftësi e për t'i përdorur konkretisht në detyrat mësimore gjatë të nxënësve.*

Ajo çka na intereson të vëmë në dukje, lidhet me faktin se si ndikon përdorimi apo mospërdorimi i aftësive vetërregulluese në dimensionet më të rëndësishme, në arritjen shkollore. Për arsye kohe, nxënësve iu kërkua që në pyetësorët e tyre të shënonin notën mesatare të tyre. Nga verifikimet e përgjigjeve të pyetësorëve dhe notave mesatare të tyre, vihet re që *ajo pjesë e nxënësve që i njeh, i vlerëson, edhe i ka përdorur aftësitë vetërregulluese* (në ndryshim me ata që i vlerësojnë por nuk kanë aftësi për t'i zbatuar), *ka vlerësime optimale krahasuar me të tjerët.*

Përfundime

- Të nxënësit vetërregullues lidhet me një sërë mendimesh, ndjenjash dhe veprimesh që shfrytëzohen nga nxënësit përpara, gjatë dhe pas kompletimit të detyrave dhe aktiviteteve mësimore.
- Ai përfshin jo vetëm komponentë konjitivë dhe metakognitivë, por edhe aspektet motivuese, emocionale dhe sjellore të të nxënësve.
- Ka korrelacion midis vetërregullimit të nxënësve nga një anë dhe qëllimeve të të nxënësve, besimeve të tyre rreth të nxënësve e aftësive personale, atribuimit të shkaktësisë, sasisë së njohurive etj., nga ana tjetër.
- Edhe pse aftësitë vetërregulluese në fëmijëri nuk janë shumë të qarta dhe të dukshme, edukimi tyre edhe në këtë moshë kurrsesi nuk duhet përjashtuar.
- Rezultatet e studimeve mbështesin fort korrelacionin midis përdorimit praktik të dimensioneve të vetërregullimit dhe arritjeve shkollore.
- Edukimi i strategjive vetërregulluese mund të fillojë që në moshat e hershme, me teknika specifike.
- Mësuesit, në cikle të ndryshme të shkollimit nuk ndihmojnë si duhet dhe sa duhet nxënësit, me teknika të përshtatëshme, për t'i fituar gradualisht këto aftësi.

Rekomandime

- Është e rëndësishme që mësuesit dhe nxënësit të njohin rolin dhe rëndësinë e procesit të vetërregullimit, fazat dhe dimensionet e tij. Hapi i parë për t'i kontrolluar faktorët e ndryshëm që mund të sjellin sukses apo të pengojnë të nxënësit, është të jesh i vetëdijshëm për to.
- Mësuesit të edukojnë nxënësit në mjediset e të nxënësve me aftësitë vetërregulluese, duke përzgjedhur teknikat më efektive, duke njohur përfundimet e kërkimeve shkencore që vetërregullimi mund të mësohet me instruksion të qartë, me reflektimin e drejtuar dhe diskutime metakognitive. Mësuesit duhet të bëhen të vetëdijshëm për rëndësinë e vetërregullimit, të jenë modele të përdorimit të strategjive efektive, të analizojnë të nxënësit e nxënësve të tyre dhe t'i pajisin ata gradualisht me aftësitë vetërregulluese të dimensioneve të ndryshme.
- Në programet e fakulteteve të edukimit të bëhet kujdes që studentët e destinuar për mësues të njohin, të përdorin dhe të nxënësi si tu mësojnë dhe si të edukojnë tek nxënësit e çdo moshë, aftësitë vetërregulluese.

Bibliografia

1. Seifert, Kelvin. & Sutton, Rosemary. (2009). Educational Psychology, Zurich, Switzerland, fq.109-131.
2. Ireson, Judith. (2008). Learners, Learning and Educational Activity, fq. 51-69
3. Woolfolk, Anita. (2011). Educational Psychology, fq. 420-491
4. Lefrançois, R. Guy. (1999). Psicologia per insegnare, Armando Editore, Roma, fq 112- 120.
5. Vasta, Ross., Haith M.Marshall., Miller, A. Scott (1992). Child Psychology, fq.492-501
6. Zimmerman, B. J. (2000). Attaining self-regulation: A social-cognitive perspective. In M.Boekaerts, P.R.Pintrich, & M. Zeidner (Eds.) Handbook of self-regulation (fq.13-39).
7. Carugati, Felice & Selleri Patrizia. (1996). Psicologia sociale dell'educazione, Societa editrice il Mulino, fq.86-98.

Sittografia

<http://www.springerlink.com>
<http://www.hindawi.com/journals/edu/2012/423284>
www.nldline.com/self_regulation.htm
www.self-regulation.cea-ace.ca/education-canada/article